

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.
më ____ . ____ .2020

Tiranë,

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nga: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)

Adresa: Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 9
Kontakt: www.ost.al; e-mail: info@ost.al.

Për: **BOE: “ALB-STAR” sh.p.k., NIPT J62903512W**
Adresa: Zona industriale Patos, nr. Pasurie 69/29, Patos
Fier
“SHANSI-INVEST” sh.p.k., NIPT J61924002T
Adresa: Tiranë, Farkë, Sauk, Farkë e Madhe
“G.M.K” sh.p.k., NIPT L62207041G
Adresa: Rr. “Durrësit”, Pall 11, shk. 6, Nr, Tiranë 41

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” - me mjete elektronike – Mallra.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje e një Autotransformatori të ri 300 MVA, 400/230 kV për N/ST Tirana 2”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) Muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Fondi Limit: 293,279,980 (dyqind e nentëdhjetë tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e nente mijë e nentëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.

Numri i references i procedures: REF-38489-10-07-2019

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 16.12.2019.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike, Nr. 41, Datë 14.10.2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojmë se kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 5 (pesë) ofertues, me vlerat

përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. BOE “ALBAELETTRICA me NIPT J61826012K, & SIEMENS d.o.o.”

Me ofertë ekonomike 280,279,380 (dyqind e tetëdhjetë milion e dyqinde e shatëdhjetë e nënt mijë e treqind e tetëdhjet) Lekë pa TVSH.

2. BOE “DULE me NIPT J82401502P & MANE/S” me NIPT J64103865K,

Me ofertë ekonomike 259,470,000 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë milion e katërqind e shtatëdhjet mijë) Lekë pa TVSH

3. BOE “ALB-STAR me NIPT J62903512W, & SHANSI INVEST me NIPT J61924002T & G.M.K POWER GROUP” me NIPT L62207041G,

Me ofertë ekonomike 284,481,580 (dyqind e tetëdhjet e katër milion e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH.

4. OE “FITRADE 2017” me NIPT L72306031V

Me ofertë ekonomike 287,414,380 (dyqind e tetëdhjetë e shtetë milion e katërqind e katërmëdhjet mijë e treqind e tetëdhjet) Lekë pa TVSH.

5. OE “NDREGJONI” me NIPT K31329048I

Me ofertë ekonomike 290,053,900 (dyqind e nëntëdhjet milion e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind) Lekë pa TVSH

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “DULE me NIPT J82401502P & MANE/S” me NIPT J64103865K, për arsyet si më poshtë vijon:

- Në marrvëshjen e bashkimit të operatorëve ekonomikë, nënshkruar me datë 14/12/2019 midis “DULE” sh.p.k dhe “MANE/S” sh.p.k, nuk është bërë ndarja e punës/shërbimit/furnizimit me elemente konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi por vetëm përqindja në raportet 80% Dule dhe 20% Mane/s. Kjo në kundërshtim me pikën 2 të nenit 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të VKM-se Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik, e ndryshuar”, ku citojmë: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.
- Nuk ka përmbushur pikën 1/d, të kriterëve të vecanta të kualifikimit, sepse deklarata për paraqitje të ofertes së pavarur sipas shtojcës 2/1, e OE “Mane/s” pjesë e bashkimit është e pa firmosur dhe vulosur.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të vecanta të kualifikimit, sepse autorizimi i prodhuesit nga “Chint”, është pa firmë dhe pa vule nga prodhuesi.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të vecanta të kualifikimit, sepse Operatori ekonomik “DULE” sh.p.k., pjesë e bashkimit, nuk ka paraqitur ISO 18001 në lidhje me sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të vecanta të kualifikimit, sepse Operatori ekonomik “DULE” sh.p.k., nuk është i pajisur me

License ne fushen e zbatimit te punimeve, Kategoria NP-11.

- Nuk ka permbushur piken 2.3.7, "Per kapacitetin teknik" te kritereve te vecanta te kualifikimit, sepse BOE "DULE & MANE/S" nuk ka paraqitur deklarate qe merr persiper shpenzimet e testimeve per 3 specialiste te Autoritetit Kontraktor per te marre pjese ne keto testime prane prodhuesit.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.8, "Per kapacitetin teknik" te kritereve te vecanta te kualifikimit, sepse ne tabelen e te dhenave teknike, pesha totale e Autotransformatorit eshte kerkuar $\leq 250,000$ kg ndersa pesha totale e ofruar eshte 289,000 kg.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.9, "Per kapacitetin teknik" te kritereve te vecanta te kualifikimit, sepse BOE "DULE & MANE/S" nuk ka paraqitur:
 - i) Suportin apo autorizimin nga prodhuesit e sistemeve te DGA-ve dhe BMT –ve per demontimin nga Autoransformatori egzistues, instalimin ne autotransformatorin e ri si dhe konfigurimin e tyre ne sistemin egzistues;
 - ii) Nuk ka ne stafin e tij asnje specialist te certifikuar per instalimin dhe komisionimin e ketyre sistemeve (sistemeve te DGA-ve dhe BMT –ve).

2. BOE ALBAELETTRICA me NIPT J61826012K, & SIEMENS d.o.o. per arsyet si më poshte:

- Kontrata per bashkimin e perkohshem te shoqerive, nenshkruar me date 11.12.2019 ne Beograd, midis operatoreve ekonomike "ALBAELETTRICA." sh.p.k dhe "SIEMENS " d.d.o, eshte nje marreveshje dypaleshe midis shoqerive e **panoterizuar**. Kjo marrveshje eshte krijuar me qellim krijimin e bashkimit te perkohshem te operatorëve ekonomikë para dorëzimit të ofertës por eshte ne kundërshtim me piken 2 te nenit 74 "Bashkimi i operatorëve ekonomikë" te VKM-se Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik, e ndryshuar", ku citojme: "*Para dorëzimit të ofertës, **bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar,** ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete,.....*". Edhe Prokura e posacme per perfaqesim e cila autorizon SIEMENS " d.d.o, eshte nenshkruar vetem ndermjet paleve pa noter. Marrveshja eshte nenshkruar ne Beograd midis paleve dhe me pas eshte bere njehsimi i dokumentit me origjinalin prane nje noteri Shqiptar.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.9, "Per kapacitetin teknik" te kritereve te vecanta te kualifikimit, sepse BOE "ALBAELETTRICA & SIEMENS" nuk ka paraqitur:
 - i) Suportin apo autorizimin nga prodhuesit e sistemeve te DGA-ve dhe BMT –ve per demontimin nga Autoransformatori egzistues, instalimin ne autotransformatorin e ri si dhe konfigurimin e tyre ne sistemin egzistues. Ka deklarate nga konçar, i cili nuk eshte prodhuesi i sistemeve ekzistuese DGA&BMT.
 - ii) Nuk ka ne stafin e tij asnje specialist te certifikuar per instalimin dhe komisionimin e ketyre sistemeve (sistemeve te DGA-ve dhe BMT –ve), sepse çertifikatat e leshuara nga "GE" prodhues i sistemit te DGA-ve jane te pavlefshme (u ka kaluar afati i vlefshmerise) dhe specialistet qe disponojne keto certifikata jane te punesuar tek "Konçar", i cili nuk eshte pjese e JV. Kurse ne lidhje me sistemin e BMT-ve nuk ka paraqitur asnje dokument.

3. OE FITRADE 2017 me NIPT L72306031V, për arsyet si më poshtë:

- Nuk ka permbushur piken 1/b,c,ç te kriterëve e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, sepse nuk ka sjellë shtojcën 8 nëpërmjet të cilës deklaron se i plotëson kriteret e vendosura në pikat b.c.ç.
- Nuk ka permbushur piken 1 / a,b,c,ç,d,dh,e, te kriterëve të veçanta të pranimit/kualifikimit, sepse nuk ka plotësuar asnjë nga shtojcat e sipas DST.
- Nuk ka permbushur pikën 2.2.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit “Për kapacitetin Ekonomik dhe financiar” pasi nuk ka dorëzuar Vërtetim nga administrata tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për 3 vitet e fundit që ushtron aktivitet dhe as kopje të certifikuara të bilanceve për keto tre vite.
- Nuk ka permbushur pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit “Për kapacitetin Teknik” pasi nuk ka dorëzuar asnjë kontratë të ngjashme dhe asnjë dokument për të vërtetuar që kryer punë të ngjashme.
- Nuk ka permbushur pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit “Për kapacitetin Teknik” pasi nuk ka dorëzuar certifikatën që vërteton që sistemi i menaxhimit të cilësive se tij është sipas standartit ISO9001.
- Nuk ka permbushur pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit “Për kapacitetin Teknik” pasi nuk ka dorëzuar certifikatën që vërteton që sistemi i menaxhimit të sigurtë se punë është sipas standartit ISO18001.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.7, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit, sepse Fittrade 2017 nuk ka paraqitur deklaratë që merr persipër shpenzimet e testimeve për 3 specialiste të Autoritetit Kontraktor për të marrë pjesë në keto testime pranë prodhuesit.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.9, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit, sepse Fittrade 2017 nuk ka paraqitur:
- i) Suportin apo autorizimin nga prodhuesit e sistemeve të DGA-ve dhe BMT –ve për demontimin nga Autoransformatori egzistues, instalimin në autotransformatorin e ri si dhe konfigurimin e tyre në sistemin egzistues;
- ii) Nuk ka në stafin e tij asnjë specialist të certifikuar për instalimin dhe komisionimin e ketyre sistemeve (sistemeve të DGA-ve dhe BMT –ve).

4. OE “NDREGJONI” me NIPT K31329048I për arsyet si më poshtë:

- Nuk ka permbushur pikën 2.3. “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi Ndregjoni nuk ka eksperiencë të ngjashme në fushën e objektit të prokurimit sipas DST. Të gjitha kontratat e paraqitura nga Operatori Ekonomik janë me objekt “Rikonstrukcion objekteve”.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.7, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit, sepse Ndregjoni nuk ka paraqitur deklaratë që merr persipër shpenzimet e testimeve për 3 specialiste të Autoritetit Kontraktor për të marrë pjesë në keto testime pranë prodhuesit..
- Nuk ka permbushur piken 2.3.8, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit
- Nuk ka permbushur piken 2.3.9, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit, sepse Ndregjoni nuk ka paraqitur:
- i) Suportin apo autorizimin nga prodhuesit e sistemeve të DGA-ve dhe BMT –ve për demontimin nga Autoransformatori egzistues, instalimin në autotransformatorin e ri si dhe konfigurimin e tyre në sistemin egzistues;
- ii) Nuk ka në stafin e tij asnjë specialist të certifikuar për instalimin dhe komisionimin e ketyre sistemeve (sistemeve të DGA-ve dhe BMT –ve).

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik **BOE “ALB – STAR” shpk** me NIPT J62903512W Adresa: Zona industriale Patos, nr. Pasurie 69/29, Patos Fier, & **“SHANSI INVEST” shpk**, me NIPT J61924002T Adresa: Tiranë, Farkë, Sauk, Farkë e Madhe, & **“G.M.K POWER GROUP” shpk** me NIPT L62207041G adresa: Rr.”Durrësit , Pall 11, shk. 6, Nr., Tiranë 41., me oferte ekonomike: **284,481,580** (dyqind e tetëdhjetë e katër milion e katërqind e tetëdhjetë e nje mijë e pesëqind e tetëdhjetë) **Lekë pa TVSH**, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë *Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë - Durrës, Km 9*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 30 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të procedohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.12.2019.

Ankesa: PO

Vendim KSHA Nr. 8533/3 Prot. Dt. 31.12.2019

ADMINISTRATORI I OST SH.A.

Skerdi Drenova